Njësia Bashkiake Nr. 8,
Rruga "Shinasi Dishnica",
Pall. 70, Kati 2, Zyra Nr. 2,
Tirana, Albania
Tel/Fax: +355 42 252 888
www.arb.al

DHKPGJP
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Nr. 1664 Prot.
Datë 06.05.2021

Datë: e mërkurë, 2021-05-05
Ora 11:30
Nr. 13/643 Prot.
Dosja Nr. 643

# URDHËR
# PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

*Drejtuar:* **Qendrës Kombëtare të Biznesit**, me adresë në: Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona Nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë;

*Për dijeni Debitorit:* Shoqëria "**B - JERA**" Sh.a., me NIPT **L71417501R**, dhe adresë në: Parku Energjitik, Porto Romano, Zona Kadastrale 3184, Pasuria Nr. 64/120, Durrës; me Administratori **Z. Klej Jera**;

*Për dijeni Kreditorit:* Shoqëria "**NAKTOR CONSTRUCTION**" **Sh.p.k.**, me NIPT **L34012202S** dhe adresë në: ndërtesë private 1 - katëshe, pranë Shkollës 9-vjeçare, Kameras, Fushë Krujë, Durrës, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori **Znj. Nertila Çitozi**.

Unë, **Alban Ruli**, përmbarues gjyqësor privat pranë **zyrës përmbarimore private ARB**, ("**ARB**") pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr. **643**, bazuar në Urdhrin e Ekzekutimit Nr. Regj. Them **1357**, datë **31.12.2020**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës,

**KONSTATOVA:**

Se më datë 14.04.2021 është depozituar pranë **ARB** kërkesa e kreditorit "**NAKTOR CONSTRUCTION**" Sh.p.k., së bashku me:

1. Urdhrin e Ekzekutimit Nr. Regj. Them **1357**, datë **31.12.2020**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili vendosi:

- *"1. Pranimin e kërkesës.*

*2. Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për detyrimin monetar sipas faturës tatimore të shitjes Nr.14, Nr. Serie 25965094, datë 16.05.2017, të lëshuar nga shoqëria "Naktor Construction" SHPK për shoqërinë "B-Jera" SHA.*

*3. Mbi detyrimin e titullit ekzekutiv të përllogariten nga përmbaruesi gjyqësor në fazën e ekzekutimit kamatat ligjore në përputhje me nenin 5 të ligjit Nr.48/2104, datë 24.04.2014, "Për pagesat vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".*

*4. Urdhërohet shërbimi përmbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat, për ekzekutimin e këtij vendimi.*

*5. Shpenzimet gjyqësore në shumën 200 (dyqind) lekë mbeten në ngarkim të kërkuesit.*

*6. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.*

*U shpall sot në Durrës, më datë 31.12.2020."*

Në vijim të procedurave përmbarimore, dhe siç palët janë në dijeni, unë, **Alban Ruli**, përmbarues gjyqësor privat pranë **ARB**, vendosa caktimin e ekspertit vlerësues kontabël **Znj. Adriana Kalaja**, për vlerësimin e e kamatave ligjore sipas pjesës arsyetuese dhe urdhëruese (pikës së tretë) të urdhrit të ekzekutimit 1357/2020 dhe sipas kërkesës së kreditorit. Në vijim të zbatimit të detyrave të saj, me Aktin e Ekspertimit Kontabël të datës **19.04.2021**, nga ana e ekspertes u paraqit Akt-Ekspertimi Kontabël, për titullin ekzekutiv - faturë tatimore e shitjes numër. **14**, nr.serie **25965094** datë **16.05.2017**, për të cilën është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit Nr. Regj. Them **1357**, datë **31.12.2020**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Me shkresën Nr. **8/643** Prot., datë **26.04.2021** *"Njoftim për vlerësimin e kamatave ligjore"*, ARB iu komunikoi palëve Aktin e ekspertimit kontabël datë 19.04.2021. Me shkresën Nr. **9/643** Prot., datë **26.04.2021** *"Njoftim"*, ARB iu komunikoi palëve vlerën e plotë të detyrimit dhe interesin ditor të kamatvonesave.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - ALBAN RULI - PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT

Pas marrjes dijeni të debitorëve, si dhe kalimit të afatit 10 (dhjetë) ditor të Lajmërimit për Ekzekutim Vullnetar, datë 14.04.2021, për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit të sipërpërmendur, duhet të kryhen bllokimet e menjëhershme të aksioneve/kuotave apo interesave të tjera të **debitorit**:

- Shoqëria "**B - JERA**" Sh.a., me NIPT **L71417501R**, dhe adresë në: Parku Energjitik, Porto Romano, Zona Kadastrale 3184, Pasuria Nr. 64/120, Durrës; me Administratori **Z. Klej Jera**.

Për sa më sipër, në zbatim të neneve **527**, e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, Ligjit Nr. **26/2019**, datë 08.05.2019 **"Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat"**, dhe Udhëzimit të Bankës së Shqipërisë "Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë",

**URDHËROJ**:

1. Vendosjen e menjëhershme të masës së sekuestros konservative në aksionet e shoqërisë "**B - JERA**" Sh.a., me NIPT **L71417501R**, dhe adresë në: Parku Energjitik, Porto Romano, Zona Kadastrale 3184, Pasuria Nr. 64/120, Durrës; me Administratori **Z. Klej Jera**; dhe moskryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar; dhe
2. Vendosjen e masës së sekuestros konservative në të tjera aksione/kuota të cilat zotërohen nga pala debitore shoqëria "**B - JERA**" Sh.a., me NIPT **L71417501R**, dhe adresë në: Parku Energjitik, Porto Romano, Zona Kadastrale 3184, Pasuria Nr. 64/120, Durrës; me Administratori **Z. Klej Jera** në shoqëritë e tjera të regjistruara pranë regjistrit tregtar.
3. Për veprimet ose mosveprimet tuaja, na informoni me shkresë, brenda afatit ligjor.
4. *Për personat që do të bëhen pengesë, do të zbatohet sanksioni i gjobës deri në shumën prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në zbatim të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile, deri në ekzekutimin e detyrimit, si edhe kallëzim penal për pengim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, në zbatim të nenit 320 të Kodit Penal.*
5. Ky Urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të interesuara, të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 (pesë) ditëve.

Zyra Përmbarimore Private ARB
Përmbaruesi Gjyqësor Privat
Alban Ruli

*Bashkangjitur do të gjeni:*

- *Urdhri i ekzekutimit Nr. Regj. Them **1357**, datë **31.12.2020**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; dhe*
- *Fatura tatimore e shitjes Numër. **14**, Nr.Serie **25965094** datë **16.05.2017**; dhe*
- *Shkresa Nr. **1/643** Prot., datë **14.04.2021** "Lajmërim për ekzekutim vullnetar" të ARB, Dosja Nr. **643**, firmosur nga debitori; dhe*
- *Shkresa Nr. **7/643** Prot., datë **16.04.2021** "Vendim për caktimin e ekspertit për vlerësimin e kamatave ligjore" të ARB, firmosur nga debitori; dhe*
- *Akti i ekspertimit kontabël datë 19.04.2021; dhe*
- *Shkresa Nr. **8/643** Prot., datë **26.04.2021** "Njoftim për vlerësimin e kamatave ligjore", ARB firmosur nga debitori; dhe*
- *Shkresa Nr. **9/643** Prot., datë **26.04.2021** "Njoftim" të ARB firmosur nga debitori; dhe*
- *Fatura tatimore Nr. **16**, datë **19.04.2021**, e ekspertes kontabël.*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS**

**Numri i Regj. Them: (90109-03800) 1357** | **Numri i vendimit: (11-2020-6591) 1357**
**Data e regjistrimit: 30.12.2020** | **Data e vendimit: 31.12.2020**

**VENDIM**

**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me trup gjykues të përbërë prej:**

**GJYQTARE: Nurjeta TAFA**

asistuar nga sekretare gjyqësore Valentina Halilaj, në Durrës, sot më datë **31.12.2020**, mori në shqyrtim pa praninë e palëve çështjen civile Nr.1357 Regjistri Themeltar që i përket:

**KËRKUES:** **Shoqëria "Naktor Construction" SHPK**, me NIPT L34012202S, me adresë: ndërtesë private njëkatëshe, pranë shkollës 9-vjecare Kameras, Fushë-Krujë, Durrës, përfaqësuar nga administratori Znj. Nertila Çitozi.

**OBJEKTI:** Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv: faturë tatimore e shitjes Nr.14, Nr. Serie 25965094, datë 16.05.2017, në vlerën neto 5,512,320 lekë, të lëshuar për shoqërinë **"B-JERA" SHA**, me NIPT L71417501R, dhe gjykata të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.

**BAZA LIGJORE:** Neni 510 dhe 511 i Kodit të Procedurës Civile, Ligji Nr.48/2014 "*Për pagesat e vonuara nga detyrimet kontraktore dhe tregtare*", Ligji Nr.9920, datë 19.05.2018, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.

Gjykata pasi u njoh me kërkesën e paraqitur nga shoqëria "Naktor Construction" SHPK për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit si dhe çmoi aktet bashkëlidhur kërkesës,

**VËREN:**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nga shoqëria "Naktor Construction" SHPK, është paraqitur kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për faturën tatimore të datës

16.05.2017. Referuar ekstraktit të QKB-së, rezulton se kërkuesi është një person juridik privat (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar), i cili, ndër të tjera, si objekt të veprimtarisë së tij ka ndërtime civile, urbane, restaurim objektesh etj. Në këtë kuadër shoqëria "Naktor Construction" SHPK ka furnizuar me materiale ndërtimi shoqërinë "B-Jera" SHA, furnizim për të cilin është lëshuar edhe fatura tatimore objekt shqyrtimi. Në kërkesën drejtuar gjykatës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit kërkuesi ka parashtruar se edhe pse fatura tatimore është nënshkruar rregullisht nga blerësi, shoqëria nuk e ka përmbushur detyrimin dhe për këtë arsye i është drejtuar gjykatës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.

## II. Analiza ligjore dhe vlerësimi i gjykatës

2. Vendimi për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titujt ekzekutivë të parashikuar në nenin 510 të K. Pr. Civile është një vendim që merret nga <u>*gjykata kompetente*</u>, pasi kompetenca është një kusht procedural i vlefshmërisë së procesit gjyqësor dhe i akteve të realizuara gjatë tij në kuptimin që "*një gjykatë jo kompetente nuk mund të kryejë asnjë veprimtari procedurale*"[1]. Për këtë arsye, përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, gjykata çmon të theksojë se në kuptim të nenit 511, shkronja "ç", të K. Pr. Civile, është kompetente për shqyrtimin e kësaj kërkese pasi selia e debitorit është në Durrës (sipas të dhënave në regjistrin tregtar). Titulli ekzekutiv përmban në thelb marrëdhënien juridike të dokumentuar në formën e kërkuar nga ligji, të cilës ky i fundit i ka njohur aftësinë për t'u ekzekutuar në mënyrë të detyrueshme sipas kërkesës së subjektit për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Që të lëshohet urdhri i ekzekutimit, së pari, duhet që akti që paraqitet nga subjekti kërkues dhe për të cilin kërkohet lëshimi i urdhrit të ekzekutimit të jetë nga ato akte që ligji i konsideron tituj ekzekutiv. Në rastin në gjykim rezulton se jemi në kushtet e nenit 510, shkronja "e", të K. Pr. Civile, i cili, sipas ndryshimit të bërë me ligjin Nr.9953, datë 14.07.2008, parashikon se: "*Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutiv: ...e) **aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutiv** dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e tyre*". Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.48/2014 "*Për pagesat e vonuara nga detyrimet kontraktore dhe tregtare*", detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor, pavarësisht vlerës.

3. Nga shqyrtimi i faturës tatimore të paraqitur në rastin në gjykim rezulton se ajo plotëson elementët e parashikuar në ligjin Nr.92/2014 "*Për tatimin mbi vlerën e shtuar*", si dhe elementët e përcaktuar në nenin 16 të ligjit Nr.48/2014 duke qenë se kjo faturë materializon një detyrim monetar të lindur nga veprimi juridiko-tregtar; veprimi është kryer midis dy shoqërive tregtare dhe konkretisht shoqërisë "Naktor Construction" SHPK dhe shoqërisë "B-Jera" SHA (shiko ekstraktet e regjistrit tregtar); detyrimi nuk është shlyer brenda afatit të pagesës pasi fatura është e datës 16.05.2017; kreditori ka kryer furnizimin dhe debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin për sa kohë që fatura tatimore rezulton e nënshkruar rregullisht. Për këto arsye gjykata vlerëson se, bazuar në nenin 16 të ligjit Nr.48/2014 si dhe nenin 510/e të K. Pr. Civile, detyrimi monetar sipas faturës tatimore objekt gjykimi përbën titull ekzekutiv. Që të lëshohet urdhri i ekzekutimit

[1] Shih, Vendimi Nr. 442, datë 11.07.2013, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

nuk është e mjaftueshme vetëm që akti për të cilin kërkohet lëshimi i urdhrit të parashikohet nga ligji si një titull ekzekutiv, por duhet të plotësohen njëkohësisht edhe kushtet kumulative të vlefshmërisë së një titulli ekzekutiv të cilët janë siguria, përcaktueshmëria dhe kërkueshmëria. Nga analiza e faturës tatimore objekt gjykimi rezulton se ajo plotëson të tre kushtet e kërkuara të vlefshmërisë për arsye se në të është parashikuar në mënyrë të qartë dhe të saktë shuma e detyrimit, fatura plotëson elementët e parashikuar në ligjin Nr.92/2014 "*Për tatimin mbi vlerën e shtuar*", i ndryshuar, dhe bazuar në nenin 6 të ligjit Nr.48/2014, afati i pagesës ka kaluar duke e bërë detyrimin të kërkueshëm.

4. Në përfundim të analizës së saj, gjykata vlerëson se kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të pranohet. Po kështu, në referim të nenit 511, paragrafi 3, shkronja "d", të K. Pr. Civile, i cili parashikon se: "*kur titulli ekzekutiv, për të cilin lëshohet urdhri i ekzekutimit, është akt për dhënie kredie bankare ose detyrime monetare. Gjykata duhet të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare*", mbi shumën e detyrimit do të përllogariten në fazën e ekzekutimit edhe kamatat përkatëse sipas ligjit Nr.48/2014, datë 24.04.2014 "*Për pagesat e vijuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare*".

**<u>PËR KËTO ARSYE</u>:**

Gjykata, bazuar në nenet 126, 309, 510/e dhe 511/ç të Kodit të Procedurës Civile si dhe ligjin Nr.48/2014 "*Për pagesat e vonuara nga detyrimet kontraktore dhe tregtare*".

**<u>VENDOSI</u>:**

1. Pranimin e kërkesës.
2. Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për detyrimin monetar sipas faturës tatimore të shitjes Nr.14, Nr. Serie 25965094, datë 16.05.2017, të lëshuar nga shoqëria "Naktor Construction" SHPK për shoqërinë "B-Jera" SHA.
3. Mbi detyrimin e titullit ekzekutiv të përllogariten nga përmbaruesi gjyqësor në fazën e ekzekutimit kamatat ligjore në përputhje me nenin 5 të ligjit Nr.48/2104, datë 24.04.2014, "*Për pagesat vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*".
4. Urdhërohet shërbimi përmbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat për ekzekutimin e këtij vendimi.
5. Shpenzimet gjyqësore në shumën 200 (dyqind) lekë mbeten në ngarkim të kërkuesit.
6. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

**U shpall sot në Durrës, më datë 31.12.2020.**

**SEKRETARE**
**VALENTINA HALILAJ**

**GJYQTARE**
**NURJETA TAFA**

| Shpenzimet gjyqësore | |
|---|---|
| Tarifa gjyqësore | 200 Lekë |
| **Totali** | **200 Lekë** |

TVSH TVSH TVSH TVSH TVSH TVSH TVSH TVSH TVSH

# FATURË TATIMORE SHITJE

Nr. i Serisë 25965094

Data: 16.05.2017

Nr. i Faturës: 14.

EMRI I SHITESIT: Nakto Konstruksion Shpk

ADRESA: Fushë-Krujë.

TELEFONI:

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIPT) L34012202S.

EMRI I BLERËSIT: B-JERA. SHA.

ADRESA: Porto-Romano Durrës.

TELEFONI:

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIPT) L71414701R.

EMRI I TRANSPORTUESIT: Nakto konstruksion shpk

ADRESA: Fushë-Krujë.

TARGA E MJETIT: ZL 76. AA 146 +C. AA 212 AI. AA 2[illegible]

ORA E FURNIZIMIT:

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIPT) L34012202S.

| Nr | Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit | Njësia e Matjes | Sasia | Çmimi për njësi pa TVSH | Vlefta pa TVSH | Vlefta e TVSH | Vlefta me TVSH |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6=4x5 | 7=6x20% | 8=6+7 |
| 1 | Çakull. | m³ | 5.800 | 350 | 2030.000 | 406.000 | 2436.000 |
| 2 | Transporti | m³ | 5800 | 442 | 2563600 | 512720 | 3.076.320 |
| | | | | | | | |
| | **TOTALI** | | | | 4593600 | 918720 | 5.512320 |

Nga të cilat: Furnizime të tatueshme

Furnizime të patatueshme

a) faqe 1: Origjinali - Bleresi
b) faqe 2: Transportuesi
c) faqe 3: Shitesi

| BLERËSI (emër, mbiemër, nënshkrimi) | TRANSPORTUESI (emër, mbiemër, nënshkrimi) | SHITËSI (emër, mbiemër, nënshkrimi, vulë) |
|---|---|---|
| Bardhyl [illegible] | Nakto Construction | Nakto Construction |

GJYQESOR PRIVAT

2

E-TVS 055/a

HSVT HSVT HSVT HSVT HSVT HSVT HSVT HSVT HSVT

Data e marrjes 2021-04-14
Ora 14:43
Nr. 1/643 Prot.
Dosja Nr. 643

LAJMËRIM
PËR EKZEKUTIM VULLNETAR

*Drejtuar Debitorit:* Shoqëria "B - JERA" Sh.a., me NIPT **L71417501R**, dhe adresë në: Parku Energjitik, Porto Romano, Zona Kadastrale 3184, Pasuria Nr. 64/120, Durrës; me Administratori **Z. Klej Jera**;

*Për dijeni Kreditorit:* Shoqëria **"NAKTOR CONSTRUCTION"** Sh.p.k., me NIPT **L34012202S** dhe adresë në: ndërtesë private 1 - katëshe, pranë Shkollës 9-vjeçare, Kameras, Fushë Krujë, Durrës, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori **Znj. Nertila Çitozi**

Unë, **Alban Ruli**, përmbarues gjyqësor privat pranë **zyrës përmbarimore private ARB**, **("ARB")** pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore **Nr. 643**, bazuar në Urdhrin e Ekzekutimit Nr. Regj. Them **1357**, datë **31.12.2020**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës,

**KONSTATOVA:**

Se me datë 14.04.2021 është depozituar pranë **ARB** kërkesa e kreditorit **"NAKTOR CONSTRUCTION"** Sh.p.k., së bashku me:

1. Urdhrin e Ekzekutimit Nr. Regj. Them **1357**, datë **31.12.2020** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili vendosi:

- *"1. Pranimin e kërkesës.*

*2. Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për detyrimin monetar sipas faturës tatimore të shitjes Nr.14, Nr. Serie 25965094, datë 16.05.2017, të lëshuar nga shoqëria "Naktor Construction" SHPK për shoqërinë "B-Jera" SHA.*

*3. Mbi detyrimin e titullit ekzekutiv të përllogariten nga përmbaruesi gjyqësor në fazën e ekzekutimit kamatat ligjore në përputhje me nenin 5 te ligjit Nr.48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".*

*4. Urdhërohet shërbimi përmbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat, për ekzekutimin e këtij vendimi.*

*5. Shpenzimet gjyqësore në shumën 200 (dyqind) lekë mbeten në ngarkim të kërkuesit.*

*6. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.*

*U shpall sot në Durrës, më datë 31.12.2020.";*

Sa më sipër, në mbështetje të neneve **517, 518, 525** të **Kodit të Procedurës Civile**.

**LAJMËROJ:**

1. Shoqëria "B - JERA" Sh.a., me NIPT **L71417501R**, dhe adresë në: Parku Energjitik, Porto Romano, Zona Kadastrale 3184, Pasuria Nr. 64/120, Durrës; me Administrator/Përfaqësues Ligjor **Z. Klej Jera**, të bëjë ekzekutimin vullnetar brenda **10 (dhjetë)** ditësh nga dita e marrjes dijeni të detyrimit ndaj palës kreditore **"NAKTOR CONSTRUCTION"** Sh.p.k., duke vepruar sipas:

- Urdhrit të Ekzekutimit Nr. Regj. Them 1357, datë 31.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;

- Sipas kerkeses se kreditorit, perveçse detyrimit kryesor (pika 2 e urdhrit te ekzekutimit) për t'u përmbushur nga pala debitore shoqëria "B - JERA" Sh.a., me NIPT L71417501R, janë dhe kamatat ligjore te përcaktuara në pikën e tretë te pjesës urdhëruese të Urdhrit të Ekzekutimit 1357/2020 dhe do te përllogariten gjatë fazës se ekzekutimit nga përmbaruesi gjyqesor nëpërmjet një eksperti te licensuar të fushës.
- Në zbatim të pikës 3 të urdhrit te ekzekutimit 1357/2020, kontratë e sherbimit do te amendohet pas perllogaritjes dhe të vlerës së kamatave ligjore duke nxjerre llogaritur dhe saktësuar tarifën fikse permbarimore lidhur me detyrimin ne total, për ekzekutimin e plote te urdhrit te ekzekutimit 1357/2020.

Sa më sipër, bazuar në Vendimin sipërcituar, debitori, Shoqëria "B - JERA" Sh.a., me NIPT L71417501R, i detyrohet kreditorit, "NAKTOR CONSTRUCTION" Sh.p.k., shumat me se paku prej:

i. Shumën **neto** prej **5,512,320.00 (pesë milion e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e treqind e njëzet) lekë**; *dhe*

ii. Tarifën përmbarimore **463,035.00 (katërqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tridhjetë e pesë) lekë** (përfshirë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar) që përfaqeson tarifën fikse, sipas përcaktimeve te Udhezimit te Perbashkët Nr. 385/7, datë 28.06.2017 "Per caktimin e tarifave per shërbimet pëmbarimore e ofruara nga sherbimi përmbarimor gjyqësor privat" i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, Seksioni III/2).

Ne total detyrohem te paguani <u>shumen me së paku</u> <u>neto</u> prej **5,975,355.00 (pesë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë) lekë** (*detyrimi kryesor dhe tarifa përmbarimore me tvsh*).

2. *Me marrjen e lajmerimit për ekzekutim vullnetar, debitori është i detyruar te deklaroje, me shkrim, gjendjen e tij pasurore, si dhe sendet ose kredi që ka sipas të tretë i detyrohen, nëse kjo kërkohet nga përmbaruesi gjyqësor. (shih nenin 517 paragrafi i dytë i Kodit te Procedurës Civile).*

3. Nëse ekzekutimi vullnetar nuk do të ekzekutohet brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e marrjes dijeni të detyrimit, ndaj palës debitore, zyra permbarimore private AR8 do të filloje ekzekutimin e detyrueshëm.

4. *Për personat që do të bëhen pengesë, do të zbatohet sanksioni i gjobës deri në shumën prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në zbatim të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile, deri në ekzekutimin e detyrimit; si edhe kallëzim penal për pengim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, në zbatim të nenit 320 të Kodit Penal.*

5. Derdhja e çdo shume të mësipërme **neto** të kryhet detyrimisht në Numrin e **Llogarisë Qëllimore, IBAN: AL40 2101 1029 0000 0000 0251 3803** në ALL (Lekë) te **Alban Ruli** pranë ABI Bank (sipas Ligjit 26/2019 *"Për shërbimin përmbarimor gjyqesor privat"*, neni 42, pika 1).

Zyra e Përmbarimit Privat AR8
Përmbaruesi Gjyqësor Privat

*Bashkangjitur do të gjeni:*
*Urdhri i ekzekutimit Nr. Regj. Themi 1357, datë 31.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;*
*Fatura tatimore e shitjes Numer 11, Nr Serie 25965094 datë 16.05.2017.*

JES GJYQESOR PRIVAT - E

**1. PËR TU PLOTËSUAR NGA ZYRA PRANUESE E LAJMËRIMIT**

Objekti D 1/643 Nr. datë 15.04.2021 Lek

Është pranuar në zyrën ... në drejtim të zotit

Shoqeria B - JERA SH.A

**2. PËR TU PLOTËSUAR NGA ZYRA MARRËSE E OBJEKTIT**

Objekti i sipërtreguar është 8/20/04/2021 Dorëzuar më datën

Paguar

Emri mbiemri i marrësit të objektit

Emri mbiemri i shpërndarësit

**SHËNIME TË VEÇANTA**

Vula datare e Zyrës Dorëzuse të objektit

POSTA
Zyra Po

RR 624 320 561 AA

39




Vula e Z; mit

**LAJMËRIM MARRJE NR ..............**

Ky lajmërim - marrje do të kthehet
në adresën time si më poshtë:

Z. Z. P. P. ARB Shqk
R. [illegible]
pll 70, kati 2, [illegible]
Tiranë

Plotësohet nga dërguesi
i cili duhet të tregojë drejtimin
e tij të plotë për kthimin
e këtij lajmërimi

MOD P6

Data e prenjes 2021-04-14
Ora 09:42
7/643 Prot
Dosja Nr. 643

**VENDIM**
**PER CAKTIMIN E EKSPERTIT PËR VLERËSIMIN**
**E KAMATAVE LIGJORE**

*Drejtuar Debitorit:* Shoqëria "**B - JERA**" **Sh.a.**, me **NIPT L71417501R**, dhe adrese në: Parku Energjitik, Porto Romano, Zona Kadastrale 3184, Pasuria Nr. 64/120, Durrës; me Administratori **Z. Klej Jera**;

*Drejtuar Kreditorit:* Shoqeria "**NAKTOR CONSTRUCTION**" **Sh.p.k.**, me NIPT **L34012202S** dhe adrese në: ndertesë private 1 - katëshe, prane Shkollës 9 vjeçare, Kameras, Fushe Kruje, Durrës, Shqiperi, perfaqësuar nga Administratori **Znj. Nertila Çitozi**.

Une, Alban Ruli, permbarues gjyqesor privat prane **zyrës permbarimore private ARB**, ("**ARB**") pasi studiova materialet e dosjes permbarimore Nr. **643**, bazuar ne Urdhrin e Ekzekutimit Nr. Regj. Them **1357**, datë **31.12.2020**, te Gjykatës se Rrethit Gjyqesor Durrës,

**KONSTATOVA:**

Se më datë 14.04.2021 eshte depozituar prane **ARB** kerkesa e kreditorit "**NAKTOR CONSTRUCTION**" Sh.p.k., se bashku me:

1. Urdhrin e Ekzekutimit Nr. Regj. Them **1357**, datë **31.12.2020**, te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Durres, i cili vendosi:

"*1. Pranimin e kerkesës.*

*2. Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për detyrimin monetar sipas faturë tatimore te shitjes Nr.14, Nr. Serie 25965094, datë 16.05.2017, të leshuar nga shoqeria "Naktor Construction" SHPK per shoqerine "B-jera" SHA.*

*3. __Mbi detyrimin e titullit ekzekutiv të përllogariten nga permbaruesi gjyqësor në fazën e ekzekutimit kamatat ligjore në përputhje me nenin 5 te ligjit Nr.48/2104, datë 24.04.2014, "Për pagesat vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".__*

*4. Urdhërohet shërbimi përmbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat, për ekzekutimin e këtij vendimi.*

*5. Shpenzimet gjyqësore ne shumen 200 (dyqind) lekë mbeten në ngarkim te kerkuesit.*

*6. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.*

*U shpall sot në Durrës, më datë 31.12.2020.*"

Në zbatim të Kodit të Procedurës Civile ("K.Pr.C."), Ligjit Nr. 26/2019, datë 08.05.2019 *"Për Sherbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat"*, Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 *"Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"* të ndryshuar, si dhe në kushtet kur kreditori **NAKTOR CONSTRUCTION** ka kerkuar vijimin e procedurave përmbarimore dhe përllogaritjen e kamatave ligjore te përcaktuara në pikën e tretë të Urdhrit të Ekzekutimit 1357/2020 sipas kërkesësës datë **14.04.2021**, si dhe dispozitivit urdhërues te pikes se trete te Urdhrit të Ekzekutimit 1357/2020, si dhe kur, llogaritja e kamatave ligjore duke filluar nga data e lindjes se te drejtes deri në ekzekutimin tërësor të detyrimit nga debitori duke vepruar sipas Urdhrit te Ekzekutimit Nr. Regj. Them **1357**, date **31.12.2020**, të Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres kerkon një akt të vlerësuar nga një specialist me njohuri të posaçme ne fushën e kontabilitetit

**VENDOSA:**

1. Të caktoj për ekspert **Znj. Adriana Kalaja**, e identifikuar nga letërnjoftimi me numër personal G46013110B, Person Fizik, me **NIPT K31610191W**, me adresë në: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nr. 4, Tiranë, me Licencë Profesionale, dhe Dëshmi për Ekspert Kontabël i Regjistruar me Nr. **744**, datë **18.11.2000**, për llogaritjen e kamatave ligjore nga data e lindjes së të drejtës deri në ekzekutimin tëresor të detyrimit nga debitori duke vepruar sipas Urdhrit të Ekzekutimit Nr. Regj. Them **1357**, datë **31.12.2020**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Të llogariten kamatat ligjore duke filluar nga data **<u>14.06.2017</u>** (30 ditë kalendarike parashikuar në nenin 6/a të Ligjit 48/2014) deri në ekzekutimin tëresor të detyrimit nga debitori duke vepruar sipas Urdhrit të Ekzekutimit Nr. Regj. Them 1357, datë **31.12.2020**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
3. Eksperti i caktuar në këtë vendim, pasi të analizojë dhe vlerësojë vlerën reale të kamatave ligjore, duke marrë si bazë të detyrueshme Urdhrin e Ekzekutimit Nr. Regj. Them **1357**, datë **31.12.2020**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe nenin 5 të Ligjit Nr. 48/2014 *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"* të ndryshuar, duhet të paraqesë në një raport me *shkrim* dhe të saktë, të dhënat e tij përfundimtare, duke iu përgjigjur pyetjes si më poshtë:

a) *Sa është vlera monetare e kamatave ligjore duke filluar nga* ***<u>14.06.2017</u>*** *deri ekzekutimin tëresor nga debitori duke vepruar sipas arsyetimit të bërë në Urdhrit të Ekzekutimit Nr. Regj. Them 1357, datë 31.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës?*

4. Raporti me shkrim i ekspertit kontabël lidhur me llogaritjen e kamatave ligjore duke filluar nga 14.06.2017 deri ekzekutimin tëresor nga debitori duke vepruar sipas Urdhrit të Ekzekutimit Nr. Regj. Them 1357, datë 31.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të paraqitet për depozitim dhe administrim pranë ARB
5. [Ek]spertimi i ekspertit kontabël t'u njoftohet palëve në proçes (debitorit dhe kreditorit) jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e përpilimit të këtij vendimi.
6. Afat për ekspertin fillon nga dita e marrjes dijeni dhe e nënshkrimit të deklaratës së betimit, se do ta kryejë këtë detyrë mirë dhe me nder dhe me qëllimin për të bërë të dituar vetëm të vërtetën.
